

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për hartimin e Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) dhe Planin Kombëtar të Integrimin Evropian (PKIE)

Ditën e hënë datë 23 tetor 2023 në orën 11:00 në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u organizua takimi i radhës me anëtarët e GNPIE, për Kapitullin 23 dhe për Kriterin Politik, ku të pranishëm ishin edhe koordinatore nga Drejtoria e Politikave të BE pranë Kryeministrisë, për të diskutuar në mënyrë të detajuar mbi procesin e hartimit të PKABE dhe PKIE, si dhe mbi afatet brenda së cilës duhet të përcillen kontributet e institucioneve.

Në kuadër të këtij procesi, institucionet përgjegjëse për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” duhet të identifikojnë dhe të vlerësojnë çdo iniciativë ligjore të re që do të përfshihet në PKIE 2024 - 2026, masat zbatuese, kostimin e këtyre masave dhe përcaktimin e burimeve financiare.

Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterin Politik do të koordinojë procesin për hartimin e PKABE 2024 - 2030 dhe PKIE 2024 - 2026 për këto kapituj. Programi Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) ka si synim të adresojë përmes masave politike dhe ligjore, institucionale, zbatuese dhe investimeve përkatëse, linjëzimin e të gjithë kuadrit rregullator shqiptar me acquis të BE-së si dhe zbatimin efektiv të tij.

